

Data_____

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirembajtje e infrastruktures te Data Center ne Primary Site dhe DR Site”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 32424000-1 -
Infrastruktura e rrjetit**

VLERA E FONDIT LIMIT: 138,971,570 (Njeqind e tridhjetë e tete milion e nentëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) leke, pa TVSH ose 1,194,222 (Një milion e njëqind e nentëdhjetë e katër mijë e dyqind e njëzet e dy) euro pa TVSH. Referuar kursit të kembimit të B.SH date 19.01.2023 ku 1 euro = 116.37 All.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur që kjo procedure të mos jete ne lote sipas arsvetimit të meposhtem:

Ne zbatim të Paragrafit 2 Pika 1 e Nenit 39 të LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme sepse nga vete objekti i prokurimit, konsiston ne qëllimin që të sigurojë funksionalitetin e pajisjeve sipas preventivit dhe riparimin e tyre sipas specifikimeve të përcaktuara në këtë dokument, në mënyrë që problematikat dhe defektet hardware të mos afektojnë punën.

Cisco Firepower është një software kyç që përdoret për kontrollin e trafikut, filtrimin e tij dhe mbrojtjen e infrastrukturës qendrore të IT nga sulmet kibernetike. Pajisjet router të implementuara si HUB ne Zyrat Qendrore, mundësojnë lidhjen e pikave me DMVPN me infrastrukturën e vendosur ne Zyrat qendrore. Ne këto pasji je jane ngritur gjithë protokollet e rrugëzimit dhe jane aplikuar te gjitha rolet e sigurise dhe monitormit te tuneleve ndermjet zyrave duke ofruar

komunikim te panderprere te aplikacioneve te nevojshme te institucionit. Switch-et e pjesës qendore te rrjetit rrugëzojnë dhe mundësojnë komunikimin e gjithë user-ave për te përfutur shërbimet e TIK. Switch të aksesit ju mundësojnë qasje ne shërbime te TIK përdoruesve ne Zyrat Qendrore. Pajisjet e përmendura me lart janë absolutisht te domosdoshme për funksionalitetin e network, kështu qe garancia për suport është e domosdoshme.

Gjithashtu kerkohet garanci dhe pergjigje e shpejte ne rastet e problematikave. Duke qene se konfigurimi i pajisjeve qendrore dhe atyre fundore duhet te kryhet nga i njejti operator pasi problematikat mund te jene nga me te ndryshmet si ne konfigurim ashtu dhe ne hardware. Theksojme se objekti ka si permbajtje garancine dhe suportin ne rastin e ndonje defekti te mundshem, nisur nga ky fakt eshte e domosdoshme qe kontrata te realizohet nga nje kontraktor i vetem.

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 53,000,000 (pesedhjetë e tre milion) leke pa TVSH.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate 3 (tre) viteve te fundit 2019, 2020, 2021. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të konfirmuara nga organet perkatese. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate rendesine e investimit dhe vleren e konsiderueshme te fondit limit te kesaj kontrate, kompleksitein e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet qe

OE ofertues te paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet te ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo me pak vitet e fundit financiare te jete ne masën 53,000,000 (pesedhjetë e tre milion) leke pa TVSH, duke qendruar madje brenda normes prej 40% te vleres se fondit limit qe prokurohet, norme shume me e ulet se ajo qe percaktohet si limit i mundshem nga LPP 162/2020 date.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per shërbimet/produktet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates në nje vlere jo më të vogël se 53,000,000 (pesedhjetë e tre milion) leke pa tvsh.

- a) Për përvoja te mëparshme të realizuar me sektorin publik, autoriteti kontraktor kerkon si dëshmi vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrence të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloje produkteve/shërbimesh, pavarësisht rendesise dhe kompleksitetit të produkteve/shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymen e konkurrencësmerise që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë/realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 40 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK, e cila ka në funksionim një seri sistemesh të ndërlidhura dhe të informatizuara e teknologjise së lartë dhe me impakt shumë të madh financiar në rast bllokimi apo mos-funksionimi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare me:

a) ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme)

b) ISO 27001:2013 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme)

c) ISO/IEC 20000-1:2011 ose ekuivalente (për menaxhimin e shërbimeve të teknologjise së informacionit).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësive implementuese.

Certifikimi **ISO 27001:2013** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rendesi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesit mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këtë kontratë do të kryesisht vijim të mirëmbajtjes dhe upgrade të sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

Certifikimi **ISO 20001-1:2011** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjise së informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

2.3.3 Për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE/BOE dhe për përmbushjen me sukses të kontratës, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim territorial për zonën gjeografike të Republikës së Shqipërisë nga Prodhuesi / Distributori i autorizuar, për shitjen dhe shërbimin e suportit të Garancive për sistemet ekzistuese të autoritetit kontraktor dhe përkatësisht për Dell, Fujitsu, Cisco, VMware, Veeam, CheckPoint, Imperva, Symantec/Broadcom, Solarwinds, Manage Engine/Zoho, objekt i këtij prokurimi. Autorizimi i Prodhuesit / Distributorit të autorizuar të përfshijë të dhëna të plota dhe detaje për kontaktin. Në rast të paraqitjes së Autorizimeve të kërkuara nga Distributori i Autorizuar respektiv të vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

Argumentimi:

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së produkteve/licensimeve specifike që kërkohen në procedurë, na garanton gjithashtu se

ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikepamja territoriale (pra per Shqiperine) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve/sherbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve / sherbimeve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve me te larta nga prodhues me fame te mire boterore dhe të zyrtarizuar ne praktikat e tyre te veprimtarise tregtare. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vertetuar se disponojnë autorizimet perkatese per furnizimin e produkteve/sherbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët perkates si dhe qe do vijojne për të zbatuar kushtet e garancisë. Duke qene se nje pjese me dermmuese e prokurimit eshte vazhdimesi per sisteme ekzistuese qe jane funksionale dhe teper te rendesishme. Operatorët Ekonomike duhet specifikisht te paraqesin Autorizimet e Prodhuesit/Distributorit nga prodhuesit/distributorët te kanalit zyrtar perkates me qellim qe te garantojne Autoritetin Kontraktor se keta operatore ekonomike kane te drejta per te rishitur keto produkte/licensa/sherbime, ne menyre qe te sigurohet vazhdimesia e procesit nga te njejtet prodhues.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.4 Per te mirembajtur sistemet e virtualizura ne Primary Site dhe ne Disaster Recovery Site, operatori ekonomik ofertues duhet te zoteroje kompetencen apo specializimin teknik per “Server Virtualization” per teknologjine VMware ose ekuivalente me te, referuar zerave respektive te objektit te prokurimit.

Te paraqitet deklarate konfirmimi nga prodhuesi zyrtar ose dukshmeria online ne web-adresen e prodhuesit zyrtar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kompetenca teknike te specializuara dhe personelin e nevojshëm të kualifikuar (qe eshte kusht kryesor qe prodhuesit e stabilizuar te zgjidhjeve te virtualizimit informatik te konfirmojne per nje OE qe kualifikohet si i tille) për realizimin me sukses të nje pjese te rendesishme te objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Funksionaliteti i skenarit Disaster Recovery me dy Site ka nje rendesi teper te larte per vazhdueshmerine dhe ruajtjen e te dhenave/regjistrimeve digjitale bazike ndervite dhe gjithashtu sensitive.

Duke qene se pjese e objektit te prokurimit eshte garancia per suport e softit ekzistues VMWARE te virtualizimit, me burim nga prodhuesi i mirenjohur nderkombetar VMWARE, ky kriter eshte vendosur pikerisht per te garantuar Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka kapacitetin, ekspertizen dhe njohurite teknike te duhura qe provohen me akreditime te fituara nga prodhuesi respektiv, nepermjet permbushjes se kriterave te percaktuara nga keto Prodhues. Ky kriter eshte

vendosur ne perpjestim me natyren dhe objektin e prokurimit te procedures konkretisht per te implementuar rrjetin e komunikimit.

2.3.5 Per te mirembajtur sistemet ekzistuese me teknologji ne Primary Site dhe ne Disaster Recovery Site, operatori ekonomik ofertues duhet te zoteroje kompetencen apo specializimin teknik per “Authorized Service Partner” per teknologjine Dell EMC ose ekuivalente me te, referuar zerave respektive te objektit te prokurimit.

Te paraqitet deklarate konfirmimi nga prodhuesi zyrtar ose dukshmeria online ne web-adresen e prodhuesit zyrtar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kompetenca teknike te specializuara dhe personelin e nevojshëm të kualifikuar (qe eshte kusht kryesor qe prodhuesit e stabilizuar te zgjidhjeve te servers, per data storage dhe data backup te konfirmojne per nje OE qe kualifikohet si servis i autorizuar prej tyre ne nje territor te caktuar gjeografik) për realizimin me sukses të nje pjese te rendesishme te objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Funksionaliteti i sistemeve te serverave DELL, i njesive ruajtese storage Dell EMC, i softuerit per backup EMC, qe mbeshtet fuqishem skenarin Disaster Recovery me dy Site eksistues, ka nje rendesi teper te larte per vazhdueshmerine dhe ruajtjen e te dhenave/regjistrimeve digjitale bazike ndervite dhe gjithashtu sensitive, ndaj nevojitet qender servisi e autorizuar lokale dhe territoriale, qe riparimet ne rast nevojje te kryhen shpejt dhe me kosto minimale per AK.

Duke qene se pjese e objektit te prokurimit eshte garancia per suport e sistemeve ekzistuese te bazuar ne zgjidhjet Dell EMC, me burim nga prodhuesi i mirenjohur nderkombetar Dell EMC, ky kriter eshte vendosur pikerisht per te garantuar Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka infrastrukturen e servisit te autorizuar territorial, kapacitetin, ekspertizen dhe njohurite teknike te duhura qe provohen me akreditime te fituara nga prodhuesi respektiv, nepermjet permbushjes se kriterave te percaktuara nga keto Prodhues. Ky kriter eshte vendosur ne perpjestim me natyren dhe objektin e prokurimit te procedures konkretisht per te implementuar rrjetin e komunikimit.

2.3.6 *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet te kete te punesuar jo me pak se 10 punonjes dhe të disponojë si staf te sajn personelin kryesor teknik, si më poshtë:*

a) Të paktën 1 (një) specialist te certifikuar "Implementation Engineer - VNX Solutions Specialist" për te implementuar dhe suportuar zgjidhjen ekzistuese Data Storage EMC;

- b) Të paktën 1 (një) specialist te certifikuar "Implementation Engineer - Data Domain Specialist" për te implementuar dhe suportuar zgjidhjen ekzistuese "Deduplication Hardware Appliance EMC";
- c) Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel Profesional "Server Engineer" për te suportuar zgjidhjen ekzistuese me Fujitsu Servers;
- d) Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel Profesional "Data Management Engineer" për te suportuar zgjidhjen ekzistuese me Fujitsu Storage DX200;
- e) Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel Profesional "CCNP" për te suportuar zgjidhjen ekzistuese Cisco Networking per "Routing and Switching";
- f) Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel Profesional "CCNP" për te suportuar zgjidhjen ekzistuese te sigurisë Cisco për "Security";
- g) Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel ekspert (CCSE) për te suportuar zgjidhjen ekzistuese Checkpoint;
- h) Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel profesional për te suportuar dhe mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese Vmware;
- i) Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar për te suportuar dhe mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese Veeam;

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, per te gjithë punonjesit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat perkatese te kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar per periudhen e dates se hapjes se tenderit.

Nje punonjes mund te kete nje ose disa certifikime, per te permbushur kriteret e mesiperme per certifikimet. Si permbledhje, operatori ekonomik duhet te paraqesi:

- *Certifikatat perkatese te kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperm;*
- *Kontratat e punonjesve dhe CV;*
- *Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjeter vertetues, per muajin e fundit;*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektivit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

1) Per kriterin ne piken a) duke qene se pjese e prokurimit eshte garancia per suport per “ zgjidhjen ekzistuese Data Storage EMC seria VNX”, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar "Implementation Engineer - VNX Solutions Specialist" për per kete lloj teknologjie, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Ky specialist kerkohet per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese.

2) Per kriterin ne piken b) duke qene se pjese e prokurimit eshte garancia per suport per “ zgjidhjen ekzistuese Deduplication Hardware Appliance EMC”, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar "Implementation Engineer - Data Domain Specialist" për per kete lloj teknologjie, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Ky specialist kerkohet per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese.

3) Per kriterin ne piken c) duke qene se pjese e prokurimit eshte garancia per suport per zgjidhjet ekzistuese “ Fujitsu servers”, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel Profesional “Server Engineer” për kete lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen ekzistuese me Fujitsu Servers, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Ky specialist kerkohet per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese.

4) Per kriterin ne piken d) duke qene se pjese e prokurimit eshte garancia per suport per zgjidhjet ekzistuese te arkivimit “ me Fujitsu Storage DX200”, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel Profesional “Data Management Engineer” për kete lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen ekzistuese te arkivimit Fujitsu, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Ky specialist kerkohet per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese.

5) Per kriterin ne piken e) duke qene se pjese e prokurimit eshte garancia per suport per zgjidhjet ekzistuese te switches network “CISCO”, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel Profesional “CCNP” për kete lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen ekzistuese CISCO per “Routing and Switching”, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Bejme sqarimin se certifikimet nga kompania multinacionale CISCO jane teper te specializuara dhe te dedikuara, ndaj duhet te jene te njejta certifikimet e kerkuara nga AK. Kjo sherben per te terhequr vemendjen e operatoreve ekonomik qe te jete teper te specializuar ne certifikimet qe do paraqesin bashke me oferten. Ky specialist kerkohet per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese në.

6) Per kriterin ne piken f) duke qene se pjese e prokurimit eshte garancia per suport per zgjidhjet ekzistuese te network NG Firewalls “CISCO”, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel Profesional “CCNP” për kete lloj teknologjie

e për të suportuar zgjidhjen ekzistuese CISCO per sigurinë “Security Routing and Switching”, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Bejme sqarimin se certifikimet nga kompania multinacionale CISCO jane teper te specializuara dhe te dedikuara, ndaj duhet te jene te njejta certifikimet e kerkuara nga AK. Kjo sherben per te terhequr vemendjen e operatoreve ekonomik qe te jete teper te specializuar ne certifikimet qe do paraqesin bashke me oferten. Ky specialist kerkohet per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese.

7) Per kriterin ne piken g) duke qene se pjese e prokurimit eshte garancia per suport per zgjidhjet ekzistuese te network “CheckPoint”, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel ekspert (CCSE) për kete lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen ekzistuese CheckPoint per sigurinë kibernetike, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Ky specialist kerkohet per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese.

8) Per kriterin ne piken h) duke qene se pjese e prokurimit eshte garancia per suport per zgjidhjet ekzistuese te virtualizimit “VMWARE”, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel profesional për kete lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen ekzistuese VMWARE per siguri maksimale ne ndertimin e makinave virtuale, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Ky specialist kerkohet per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese.

9) Per kriterin ne piken i) duke qene se pjese e prokurimit eshte garancia per suport per zgjidhjet ekzistuese te virtualizimit “VEEAM”, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel sa me larte për kete lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen ekzistuese VEEAM per siguri maksimale ne ruajtjen e makinave virtuale, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Ky specialist kerkohet per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese.

Listpagesa apo nje dokument vertetues i listes se personelit, e muajit te fundit, vertetimi tatimor per nr total te personelit te kontraktorit, kontratat e punes me stafin perkates teknik, jane grupi i dokumentave teper te lehte per tu paraqitur paraprakisht nga OE bashke me formularin e ofertes tekniko-ekonomike dhe vetedeklarimet e tjera, ne menyre qe te behet nje vleresim sa me i drejte dhe profesional nga KVO.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate teknologjite ekzistuese dhe nevojat per funksionalitet zgjerim cilesi e performance te disa prej sistemeve ne zoterim nga Autoriteti Kontraktor, per blerjet e reja cilesore qe zgjerojne ato ekzistuese dhe upgrade (permiresim) te sistemeve ekzistuese sipas objektit te procedures se prokurimit, duke perlllogaritur menyren e

ofrimit të produkteve dhe shërbimeve e garancive të suportit, karakteristikat e duhura, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ruajtur garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pikë 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pikë 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në çdo rast ku nuk ka qenë një teknologji ekzistuese që duhet garantuar, zgjeruar, përmirësuar dhe integruar është përdorur termi “ose ekuivalent” për të qenë gjithmone në konformitet me zbatimin e legjislacionit të prokurimeve publike dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

Termat e References/Specifikimet teknike dhe kriteret e vecanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdher të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedurë prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.